



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2021:242627  
Datë: 15.04.2024  
Numri i dokumentit: 05572749

**E.nr.567/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit S.B. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av Nazmije Ibrahimimi nga Ferizaj, kundër debitorit Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj, për pagesën e shpërblimit jubilar dhe shpenzimet e procedurës, më datë 15.04.2024, mori këtë:

## **A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.567/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

### **A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.567/23, të datës 08.05.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj, për pagesën e shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit 2021:242628, të datës 26.01.2023.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 15.09.2023 dhe të datës 15.04.2024, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit t'i transferoj shumat e përgjithshme të mjeteve prej 1,150 euro dhe shumën prej 258.73 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.567/23, më datë 15.04.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**